

MA-215 MATIFAST

Ngjitës pllakash me bazë çimentoje me tharje të shpejtë, i modifikuar me polimere, me forcë të lartë ngjitëse dhe pa rrëshqitje vertikale, me Fibre Strength Tech.



PAKETIMI
25kg



RAPORTI I PËRZIERJES
6-7 L/25kg



KONSUMI
3-5 kg/m²

Përshkrimi

MA-215 MATIFAST është një ngjitës pllakash me bazë çimentoje me tharje të shpejtë, i modifikuar me polimere, me forcë të lartë ngjitëse dhe pa rrëshqitje vertikale, me Fibre Strength Tech. Ofron forcë të lartë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare, si dhe qëndrueshmëri ndaj lagështisë.

Fusha e Përdorimit

-Përdoret për ngjitjen e pllakave të brendshme të dyshemesë qeramike në një sërë nënshtratesh si betoni, suva, etj.

-Mund të përdoret për raste ku kërkohet rikthim i shpejtë në shërbim, siç janë zyrat, qendrat tregtare, etj.

Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqja që do të mbulohet me pllaka duhet të jetë pa pluhur, yndyrë, bojë, etj. Rekomandohet ta lagni sipërfaqen para aplikimit. Përdorni riparuesin MATIART në rastin e nënshtrësave të pabarabarta, për të marrë një sipërfaqe të sheshtë. Nëse është pluhurosur, fshini pjesën e pasme të pllakave me ujë.

Aplikimi

MA-215 MATIFAST shtohet ngadalë në ujë duke e përzier vazhdimisht, derisa të formohet një pastë homogjene. Rekomandohet përdorimi i një mikseri me shpejtësi të ulët për përzierjen.

Përzierja duhet të lihet të pushojë për rreth 3 minuta para se të përziehet përsëri për pak. Për të siguruar ngjitje të mirë, shpërndani llaçin mbi sipërfaqe me anën e shpatullës të sheshtë dhe dhëmbëzoni me anën e dhëmbëzuar. Madhësitë e dhëmbëve duhet të jenë të përshtatshme për përmasat e pllakave. Instaloni pllakat mbi llaçin e dhëmbëzuar brenda kësaj periudhe me presion të fortë. Kushtet klimatike të pafavorshme (temperaturë e lartë, lagështi e ulët, erë, etj.) mund ta zvogëlojnë këtë kohë. Nëse kalon kjo periudhë, duhet të hiqni llaçin. Përzierja e aplikuar duhet të mbulohet me pllaka, mermer ose granit brenda 20 minutash.

Konsumi

Konsumi është 3-5 kg/m², varësisht nga sipërfaqja.

Karakteristika



Të dhëna teknike (NE +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E bardhë
Magaznimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	6-7 litra ujë / 25 kg pluhur
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Trashësia e aplikimit	Deri në 10mm
Koha e puneshmërisë	45 Minuta
Rrëshqitshmëria (EN 12004-2)	≤0.5mm
Koha e hapjes (EN 12004-2)	Pas 30 minutash ≥ 0.5 N/mm ²
Forca e ngjitjes (EN 12004-2)	
- Fillestare	Pas 6 orësh ≥ 0.5 N/mm ²
- Pas ekspozimit ndaj nxehtësisë	≥ 1 N/mm ²
- Pas zhytjes në ujë	≥ 1 N/mm ²
- Pas cikleve të ngrirjes/shkrirjes	≥ 1 N/mm ²
Deformueshmëria (EN 12002)	≥ 2.5mm – S1 E deformueshme
Shkalla e temperaturës	(-40°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	A1
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS

MATIS Construction Chemicals

Tiranë, Albania

info@matís-eu.com

www.matis-eu.com

T: +355 69 20 94 570

THIS TECHNICAL DATA SHEET SUPERSEDES ALL PREVIOUS EDITIONS RELEVANT TO THIS PRODUCT

2/2

DISCLAIMER: The above technical data, information, recommendations and guidance are based on scientific and technical knowledge, laboratory studies and long experience. However, the above information is considered to be as indicative and should be reviewed in any case in relation to each specific application conditions. Consequently, the suitability of each product in any application must be evaluated after referring to the updated Technical Data Sheet and to the website www.matis-eu.com, as well as after contacting the technical support department, in case of necessity. Our company guarantees the quality of the product itself, whilst in any case the user/applicant is exclusively responsible for any undesirable failures after using the product.